



Moraliteti seksual dhe drejtësia shoqërore në krishterim

Description

Thomas Rausch SJ

Dishepullësia e krishterë duhet të frymëzojë si jetën tonë ndërpersonale ashtu dhe atë shoqërore. Moraliteti seksual merret me shprehjen epërshtatshme të shtysës për intimitet, dashuri dhe riprodhueshmëri, e cila luan një rol mjaft të rëndësishëm në marrëdhëniet tona ndërpersonale. Drejtësia shoqëroreë përshkruan atë që ndodh kur shoqëritë tona janë të organizuara në atë mënyrë që secili person është i respektuar dhe të gjithë kanë të mundur të marrin pjesë në jetën shoqërore, politike dhe ekonomike të bashkësisë. Problemet e ngritura nga të dyja këto fusha na prekin personalisht. Të dyja janë trajtuar gjerësisht nga autoriteti i mësimave të Kishës, dhe të dyja janë sfera diskutimi që prodhojnë emocione tëkonsiderueshme, shqetësim dhe reagime shumë tëndryshme ndaj autoritetit të Kishës. Disa katolikë sot nuk pajtohen me mësimet e Kishës mbiçështjet ekontrollit të lindshmërisë, divorcit dhe martesës së sërishme, marrëdhëniet seksuale jashtëmartesës dhe ndërmjet homoseksualëve tëbindur, dhe (në një masë më të vogël) abortit. Katolikë tjetërë, të cilët pranojnë mësimet e kishës mbi këto çështje, kanë vështirësi tëkonsiderueshme tëpranojnë mësimet e saj në sferat e drejtësisë shoqërore, për shembull, në të drejtën e popujve për tëemigruar, në çështjen epërdorimit të armëve bërthamore si frenues, dhe ndërlikimet e parimit tëdrejtësisë shpërndarëse e cila pohon të drejtën e të gjithë anëtarëve të njëkomuniteti kombëtar për tëmarrë pjesë në mënyrë të barabartë në jetën ekonomike. Në mënyrë të ngjashme, në të kaluarën disakatolikë nuk janëpajtuar me mësimet e kishës mbi të drejtën e punonjësve për t'iu bashkuarsindikatëve apo me dënimin e ligësisë së racizmit dhe segregacionit. Njëkëtë kapitull ne do tëkonsiderojmë si moralitetin seksual ashtu dhe drejtësinë shoqërore.

Moraliteti seksual

Është mëse e ndershme të pranohet se Kisha Katolike është treguar thellësisht në mëdyshje në sjelljen e saj ndaj seksualitetit njerëzor. Në njërinkrah, ajo e ka pranuar gjithmonë seksualitetin si një të mirë, një dhuratë që Zoti ua dha prindërve tanë të parë për dashurinë e tyre reciproke dhe përsjelljen në botës të jetës së re. Kjo ka mbetur bindja më e thellë e traditës katolike. Në krahun tjetër, kisha është dukur shpeshherë e trembur nga fuqia e misterit të seksualitetit. Duke i bërë jehonë pesimizmit të Agustinit, ajo ka ngushtuar shpeshherë kuptimin e bashkimit seksual në sjellje nëjetë, vështirë se ka toleruar kënaqësinë që marrin njerezit nga njëri-tjetri gjatë aktit, dhe ka zhvilluar rreth saj një teologji morale që ka patur prirjen tashikojë seksualitetin në termat e veprave të ndarjes e jo si marrëdhënie komplekse njerëzore.

Këndvështrimi katolik se seksualiteti njerëzor është një dhuratë hyjnore që gjen shprehjen e duhur të pjellorisë në një marrëdhënie dashurie dhe tëposaçme, e hapur ndaj jetës së re, i ka rrënjët në shkrimet e shenjta. Libri i Zanafillës mëson se seksi ekziston për sjelljen në jetën (1:28) dhedashurinë e ndërsjellë (2:18-24). Kënga e Këngëve, një poemë haptazi erotike, kremton dashurinë fizike mes burrit dhe gruas. Jezui vuri kushtinstitucionin hyjnor të martesës dhe konfirmoi përjetësinë e saj. Duke refuzuar dispozitat e Ligjit të Moisiut që i lejonte një burri të divorcohej ngabashkëshortja e tij por jo e kundërta, ai predikoi një reciprocitet në marrëdhëniet seksuale që nuk qe nderuar në atë traditë. Pali e njeh martesën si një dhunti shpirtërore, një dhuratë prej hirit për ngritjen e Kishës (1Kor 7:7). Letra e Efesianëve e shikon bashkimin intim të burrit dhe gruas si një mister të madh (*mysterion*) që i shëmbëllen bashkimit të Krishtit dhe të Kishës (Ef 5:31-32), një kuptim intuitive i asaj çka më vonë kisha do ta njihnte si sakramenti i martesës.

Date Created

08/10/2014

Author

erasmusi